



BASHKIA MIRDITË

Nr. 53 20 prot.

Rrëshen 27 / 29 / 2016

KONTRATË MBIKQYRJE PUNIMESH

OBJEKTI

**“Mbikqyerje e punimeve për objektin: “Rikualifikim urban
i qendrës së qytetit Rrëshen” Bashkia Mirditë**

MBIKQYRËSI I PUNIMEVE

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

**“NRB Engineering Studio” SHPK
DREJTUES LIGJOR**

NDREC DEDAJ

NIKOLIN GJONAJ



Adresa: Sheshi "Abat Doçi" Rrëshen

KONTRATË

MBIKQYRJE PUNIMESH NDËRTIMI

“Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rikualifikim urban i qendrës së qytetit Rrëshen” Bashkia Mirditë

Në zbatim të ligjit nr. 8402 Dt. 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinën e punimeve të ndërtimit” ndryshuar me ligjin Nr 9794 dt 23.07.2007, Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.3, datë 15.02.2001 me gjithë ndryshimet e Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.4, datë 17.05.2001 si dhe Udhëzimit të Këshillit të Ministrave Nr.2, datë 13.05.2005, Udhëzimit Nr 1, datë 16.06.2011 për “Disa ndryshime në udhëzimin Nr 3 datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave, “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit, të ndryshuar” si dhe kontratës së sipërmarrjes së lidhur me shoqerine “T.T.A ALBA LAM shpk” me nr.prot, _____, datë _____, për **“RIKUALIFIKIM URBAN I QENDRËS SË QYTETIT RRËSHEN ” BASHKIA MIRDITË** lidhet kontrata midis:

Bashkia Mirditë, e përfaqësuar nga **Z. Ndrec Dedaj**, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor , që më poshtë do të quhet **“Autoriteti Kontraktor”**;

dhe

Shoqërisë “NRB Engineering Studio & Zenit - 06 ” SHPK me licencë “Për mbikqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi nr. MK 2498, lëshuar nga Ministria e Punëve publike dhe Transportit, Komisioni i Posacem i Dhënies së Licensave Profesionale per shoqerite qe ushtrojne veprimtari ndertuese zbatimi, me Nipt L31804009R dhe me adresë së ushtrimit të Biznesit Rruga "Shefqet Musaraj" Pallati 52, kati 7, ap. 29 (Pas Universitetit Europian)

i mëposhtëquajtur **“Mbikqyrës i Punimeve;**

Objekti i kësaj kontrate është drejtimi i punimeve të zbatimit me objekt: Mbikqyrja e punimeve për objektin: Mbikqyrja e punimeve për objektin: **“Rikualifikim urban i qendrës së qytetit Rrëshen” Bashkia Mirditë”**

Kjo kontratë lidhet sot më datë ___/___/2016, në mbështetje të dispozitave ligjore për drejtimin dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit dhe konkretisht Udhëzimit Nr 1, datë 16.06.2011 për “Disa ndryshime në udhëzimin Nr 3 datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave, “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit, të ndryshuar”, nëpërmjet procedurës së prokurimit ne mbështetje të ligjit nr 9643 dt 20.11.2006 për “Prokurimin Publik” (të ndryshuar) dhe akteve nënligjore të tij përzgjedh shoqërinë “ NRB Engineering Studio & Zenit - 06” shpk, Mbikqyrës të Punimeve në objektin “Rikualifikim urban i qendrës se qytetit Rrëshen” Bashkia Mirdite ”.

Palët bien dakort për kushtet që vijojnë:

1. Mbikqyrësi i punimeve përgjigjet për ndjekjen e realizimit pikë për pikë të kontratës së nënshkruar midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit për realizimin e fazave të ndryshme të zbatimit të respektimit të afatit të dorëzimit dhe koston së objektit.



2. Mbikqyrësi i punimeve përgjigjet për ndërtimin e objektit në përputhje me projektin dhe kushtet teknike të zbatimit në fuqi për mbikqyrjen dhe përshkrimin e zbatimit të projektit, cilësinë e materialeve të përdorura që të plotësojnë kërkesat e objektit si dhe për vendosjen në vepër të elementeve të parapërgatitura.
3. Mbikqyrësi i Punimeve i njofton me shkrim për çdo problem që mund të lind gjatë zbatimit të punimeve, Autoritetin Kontraktor.
4. Mbikqyrësi i punimeve duhet të ruaj dhe kontrollojë të gjitha dokumentat e përcaktuara në ligjin nr. 8402 Dt. 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinën e punimeve të ndërtimit" ndryshuar me ligjin Nr 9794 dt 23.07.2007 si dhe në U.K.M. Nr. 3, datë 15.02.2001 që Kontraktuesi do të depozitojë në Bashkinë Mirdite.
5. Mbikqyrësi i Punimeve gjatë zbatimit të objektit ngarkohet të japë instruksione dhe urdhëra me shkrim Kontraktuesit sa herë që e sheh të nevojshme, Kontraktuesi është i detyruar t'i zbatojë ato. Ky i fundit ka të drejtë të bëjë me shkrim vërejtjet e tij lidhur me instruksionet dhe urdhërat e lëshuara nga ana e Mbikqyrësit të Punimeve.
6. Mbikqyrësi i Punimeve ka të drejtën që me miratimin e Autoritetit Kontraktor të japë urdhërat me shkrim për ndryshimet që ai i sheh të arsyeshme që duhen bërë gjatë zbatimit të veprës. Në raste urgjente Mbikqyrësi i Punimeve mund të urdhërojë me shkrim zbatimin e menjëhershëm të ndryshimeve.
7. Mbikqyrësi i Punimeve ka të drejtë të kërkojë largimin nga puna të drejtuesit të kantierit ose specialistëve të veçantë për mosbindje, paaftësi ose pakujdesi të rëndë.
8. Materialet që do të përdoren në vepër duhet të jenë në përputhje me kërkesat e kontratës. Ato mund të përdoren në vepër vetëm me miratimin e Mbikqyrësit të punimeve. Materialet e ardhura në kantier që nuk pranohen nga Mbikqyrësi i Punimeve zëvendësohen me të tjera me shpenzimet e Kontraktorit .
9. Mbikqyrësi i Punimeve ka të drejtë të vendosi të bëjë prova të materialeve për të verifikuar cilësinë e tyre. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të Kontraktorit.
10. Kur Mbikqyrësi i Punimeve mendon se ka defekte në konstruksione apo në pjesë të tjera të veprës, kërkon të bëhen verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i japin të drejtë Mbikqyrësve të punimeve shpenzimet janë në ngarkim të Kontraktorit në rast të kundërt Kontraktori ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve.
11. Kur urdhërohet nga Mbikqyrësi i Punimeve, Sipërmarrësi duhet të prishë dhe ribëjë me shpenzimet e veta punimet e kryera jo me cilësinë e parashikuar ose me materiale sipas përshkrimeve të projektit dhe standarteve në fuqi.
12. Mbikqyrësi i Punimeve ka të drejtë të pezullojë përkohësisht punimet kur gjykon se ka shkaqe për këtë. Kjo ndërprerje nuk duhet të zgjasë më shumë se



1/3 e kohëzgjatjes së punimeve sipas kontratës së nënshkruar por në çdo rast jo më shumë se 6 muaj.

13. Kur Investitori lejon shmangie në përmasa ose cilësi, Mbikqyrësi i Punimeve, gjithmonë në qoftë se vepra është e pranueshme duhet të zbatojë një zbritje të çmimeve si kontabilitet dhe si vlerësim përfundimtar në kolaudim.
14. Kontraktori duhet ti njoftojë me shkrim Mbikqyrësit të Punimeve përfundimin e punimeve në objekt. Më këtë rast ai i paraqet Mbikqyrësve të punimeve dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Kontratën dhe aktet e tjera që lidhen me to;
 - b) Proçesverbalet e dhënies, ndërprerjes, zgjatjes para dhe pas përfundimit të punimeve;
 - c) Kërkesat e tij.
15. Mbikqyrësi i Punimeve duhet ti paraqesë Autoritetit Kontraktor materialet e sipërmendura të marra në dorëzim nga Kontraktori së bashku me relacionin e vet.
16. Në përfundimin e punimeve brenda 30 ditëve Mbikqyrësi i Punimeve duhet të depozitohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve një relacion në dy kopje, rreth zbatimit të punimeve me karakteristikat dhe cilësinë e materialeve të përdorura në vepër duke paraqitur:
 - a) Çertifikatat e provave të materialeve të përdorura lëshuar nga laboratorët e autorizuar për këtë qëllim.
 - b) Për objektin çdo të dhënë për plotësimin në vepër të kësaj strukture.
 - c) Përfundimet e provave të kryera nën ngarkesë duke bashkalidhur aktet e mbajtura për këtë qëllim.
 - d) Deklarata që objekti është zbatuar në përputhje me projekt zbatimin, sipas formularit që merret nga Investitori.
 - e) Njëra prej dy kopjeve të konfirmuara nga Mbikqyrësit e Punimeve i dërgohet kolaudatorit.
17. Mbikqyrësi i Punimeve asiston në kolaudimin e veprës i përgjigjet kolaudatorit për të gjithë dokumentacionin e nevojshëm gjatë kolaudimit të veprës si dhe firmos proçes-verbalin e kolaudimit.
18. Mbikqyrësi i Punimeve është përgjegjës për fondin e veprës. Situacionet e paraqitura nga Kontraktori pas kryerjes së punimeve në faza të ndryshme mund të paguhet nga Investitori vetëm pasi të jenë shqyrtuar dhe firmosur nga Mbikqyrësi i Punimeve.
19. Mbikqyrësi i Punimeve nuk duhet të këtë lidhje pune, gjaku apo interesash as me Kontraktorin dhe as me kolaudatorin në të njëjtën kohë ai nuk duhet të ketë asnjë pengesë të këtij lloji me projektuesin. Për këtë qëllim Mbikqyrësi i Punimeve do të bëjë një deklaratë me shkrim Autoritetit Kontraktor.
20. Kur vërehen shkelje të dispozitave ligjore Investitori ka të drejtë t'i urdhërojë Mbikqyrësit të Punimeve pezullimin e punimeve dhe i lind e drejta të kryej prishjen e kontratës duke kërkuar dëmshpërblim Mbikqyrësit të punimeve për dëmin e shkaktuar prej tij .



21. Kur shkeljet e dispozitave ligjore nuk përbëjnë vepër penale Investitori mund të dënojë me gjobë Mbikqyrësin e Punimeve në masën nga 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë deri 200.000 (dyqindmijë) lekë në përputhje të ligjit "Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimeve". Në rast se Mbikqyrësi i punimeve kryen shkelje financiare të cilat përbëjnë vepër penale përgjigjet në përputhje të legjislacionit në fuqi.
22. Vlera e plotë e mbikqyrjes në objekt është: **1,890,000 Lek me TVSH** (Një milion e tetëqind e nëntëdhjetë mijë), vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkise.
23. Mbikqyrësi i punimeve, **Shoqëria "NRB Engineering Studio" SHPK** për drejtimin e punimeve në objekt për kohën e punës që është në dispozicion të Autoritetit Kontraktor paguhet prej tij me pagën në shumën **1,890,000 Lek me TVSH** (Një milion e tetëqind e nëntëdhjetë mijë). Vlera totale është përlllogaritur deri në momentin e përfundimit të punimeve dhe marrjen në dorëzim të punimeve, sipas kushteve të parashikuara në kontratën e lidhur midis palëve.
23. Afati i kësaj kontrate shtrihet paralelisht me afatin e kontratës së lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktorit për zbatimin e objektit duke përfshirë dhe shtyrjet e mundshme të afatit që mund të lindin gjatë zbatimit të kontratës.
24. Pagesa e Mbikqyrësit të punimeve do të kryhet në bazë të përqindjes së situacioneve që do të paraqiten për likuidim nga ana e shoqërisë zbatuese të objektit.
25. Mbikqyrësi i Punimeve gjatë gjithë veprimtarisë duhet të zbatojë të gjitha dispozitat e parashikuara në këtë kontratë si dhe kërkesat e detyrimet që rrjedhin nga ligji nr. 8402 dt. 10.09.1998 të ligjit ndryshuar me ligjin Nr 9794 dt 23.07.2007 si dhe të udhëzimit nr.3 dt.15.02.2001, dhe udhëzimit nr.4, datë 17.05.2001 "Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", si dhe mban përgjegjësi sipas dispozitave ligjore në fuqi për mos respektimin e tyre.
26. Mosmarrëveshjet që lindin midis palëve zgjidhen me mirëkuptim në rast të kundërt, kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Mirditë.
27. Kjo kontratë hartohet në 5 kopje prej të cilave një kopje e mban Mbikëqyrësi i Punimeve dhe katër kopje Investitori.


MBIKQYRËSI I PUNIMEVE

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

"NRB Engineering Studio" SHPK
DREJTUES LIGJOR

NIKOLIN GJONAJ

NDREC DEDAJ



5

Adresa: Sheshi "Abat Doçi" Rreshen